

PËRMBLEDHJE JO – TEKNIKE

EMËRTIMI I PROJEKTIT:

**SHFRYTËZIM I MINERALIT GURË GËLQEROR, NË ZONEN E MALIT TE
PASHKASHESHIT**

Sipas shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, pika 19: Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë. Procedurë e thelluar e vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

VENDNDODHJA

**ZONA MINERARE 122/9, FSHATI PASHKASHESH, NJËSIA
ADMINISTRATIVE BËRZHITË, QARKU TIRANË**

Kërkues:

Subjekti “Kronos Konstruksion” Sh.p.k

NIPT: K41416033P

Administratori

Z. Vasil Jovani



Përmbledhje

1. Hyrje	3
2. Vendndodhja e projektit	3
3. Përshkrim i projektit	5
4. Karakteristikat e projektit karrierë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror	6
5.1 Kryerja e punimeve për shfrytëzimin e karrierës.....	6
5.2 Parashikimi i realizimit të prodhimit në objekt.....	6
5.3 Rradha dhe drejtimi i shfrytëzimit	7
5.4 Punët me lëndët plasëse.....	8
5.5 Organizimi	8
Masat për rregullimin e infrastrukturës	9
Hapja e kanaleve për drenazhim midis kollonës mbrojtëse dhe zonës së shfrytëzimit	9
Punimet plotësuese për mbylljen e karrierës	9
5. Informacion mbi përzgjedhjen e vendndodhjes së projektit	9
6. Identifikimi i ndikimeve	10
1. Ndikimet në tokë.....	10
2. Ndikime në topografinë lokale, erozionin e tokës	11
3. Ndikimet në ujë.....	11
4. Ndikimet në ajër.....	11
5. Ndikime në zhurma dhe vibrime.....	12
6. Ndikimet në biodiversitet	12
7. Ndikime në infrastrukturën e zonës	13
8. Ndikime në trashëgiminë kulturore.....	13
9. Ndikime të tjera	13
7. Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit	13

1. Hyrje

Shoqëria “Kronos Kostruksion” sh.p.k. ka selinë e vet kryesore në Bulevardin Gjergj Fishta, pranë ish ekspozitës Shqipëria sot (sipas Ekstraktit të QKR). Kjo shoqëri administrohet nga Z. Vasil Jovani dhe është e regjistruar në regjistrin tregtar me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NIPT): K41416033P me datë regjistrimi 19.03.2002. Kjo shoqëri do të zhvillojë aktivitetin e saj “Shfrytëzim guri gëlqeror me karrierë sipërfaqësore” me vendndodhje në zonën e malit të Pashkasheshit, Njësia Administrative Bërzhitë, Qarku Tiranë.

Qëllimi i përgatitjes së Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është pikërisht identifikimi i impakteve negative dhe pozitive që do të ketë ky aktivitet në mjedisin rrethues si dhe impaktin social – ekonomik.

2. Vendndodhja e projektit

Objekti “Karrierë për shfrytëzim guri gëlqeror” sikurse u përmend edhe më sipër, ndodhet në zonën e malit të Pashkasheshit, midis fshatit Pashkashesh dhe Pellumbas, Njësia Administrative Bërzhitë. Bazuar në ndarjen territoriale kjo zonë i përket Bashkisë së Tiranës. Qendra më e afërt e banuar është fshati Pashkashesh rreth 600m në vijë ajrore. Nga pikëpamja gjeologjike vendndodhja e objektit përputhet plotësisht me synimin e shoqërisë që ti afrohet tregut të përdorimit të materialeve të ndërtimit, si material të gatshme për sektorin e ndërtimit.

Sipërfaqja e kërkuar dhe e miratuar edhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës për shfrytëzimin e gurit gëlqeror është 3.6ha ose 0.036km². Kapaciteti prodhues është përcaktuar 20 000 m³/vit.

Objekti në aspektin gjeografik, bën pjesë në planshetën e hartës 1:25000 me nomenklaturë K-34-100-B-d (Krraba) dhe administrohet nga Bashkia e Tiranës, rrethi Tiranë. Kufiri i zonës që do të shfrytëzohet kufizohet me koordinatat e mëposhtme:

Pika	Koordinatat	
	X	Y
1	45 67 500	44 14 575
2	45 67 475	44 14 850
3	45 67 350	44 14 850
4	45 67 350	44 14 600

Sipërfaqja e kësaj zone është 0.036 km²ose 3.6 ha

Objekti lidhet me rrugë të kategorisë së katërt, me rrugën Pashkashesh – Pëllumbas – Autostrada Tiranë - Elbasan. Gjatësia e rrugës lidhëse të objektit me rrugën e mësipërme është rreth 8 km. Rruga aktuale që do të përdoret më shumë është rruga që lidh karrierën e rrugës Pashkashesh – Pëllumbas.

Në objektin karrierë për shfrytëzim guri gëlqeror, me sipërfaqe 0.036 km^2 (3.6ha) rezervat e nxjerrshme janë $800,600 \text{ m}^3$ masiv.



Foto ajrore e zones

Objekti, sic është lartpërmendur, ndodhet në një distancë në vijë ajrore rreth 600 m nga fshati Pashkashesh dhe 2 km larg fshatit Krrabe. Gjithashtu ndodhet në një distancë prej rreth 2 km, në vijë ajrore, nga fshati Pëllumbas



Informacioni mbi qendrat e banuara të bashkisë Tiranë ku përfshihet edhe zona e Pashkasheshit, zona në studim.

QARKU TIRANË

Nr.	Njësi të qeverisjes vendore				Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë		
XI.	Tiranë	Qyteti Tiranë	Tiranë	Qyteti Tiranë	Tiranë	Njësia bashkiake nr.1, Njësia bashkiake nr.2, Njësia bashkiake nr.3, Njësia bashkiake nr.4, Njësia bashkiake nr.5, Njësia bashkiake nr.6, Njësia bashkiake nr.7, Njësia bashkiake nr.8, Njësia bashkiake nr.9, Njësia bashkiake nr.10, Njësia bashkiake nr.11
					Petrelë	Fshatrat; Petrelë, Mullet, Stërmas, Picall, Shënkoll, Gurrë e Madhe, Gurrë e Vogel, Daias, Barbas, Fikas, Mangull, Qeha, Shytaj, Hekal, Kryezi, Percëllesh, Durishtë
					Farkë	Fshatrat; Farkë e Madhe, Farkë e Vogel, Lundër, Mjull Bathore, Sauk, Selitë
					Dajt	Fshatrat; Linzë, Shishtufinë, Tujan, Brnar, Ferraj, Priskë e Madhe, Surrel, Lanabreges, Shkallë, Qafmollë, Darshen, Selbë, Murth
					Zall-Bastar	Fshatrat; Zall-Bastar, Bastar i Mesëm, Bastar – Murriç, Vëlëz, Zall-Mner, Mner i Sipërm, Bulçesh, Zall Dajt, Besh, Dajt, Shëngjin i Vogël, Selitë Mali
					Bërzhitë	Fshatrat; Ibë, Bërzhitë, Döbresh, Ibë e Poshtme, Pëllumbas, Mihajas-Cirmë, Kus, Fravesh, Kllojkë, Pashkashesh, Lugë-Shalqizë, Rozaverë
					Krrabë	Qyteti Krrabë, Fshatrat; Mushqeta, Skuterë
					Baldushk	Fshatrat; Baldushk, Mumajes, Fushas, Balshaban, Shpatë, Isufmuçaj, Mustafakoçaj, Koçaj, Kakunj, Vesqj, Parret, Shënkoll, Vrap, Shpat i Sipërm
					Shëngjergj	Fshatrat; Shëngjergj, Verri, Urë, Burimas, Shëngjin, Façesh, Bizë, Fage, Parpujë, Vakumone, Domje, Derje
					Vaqarr	Fshatrat; Vaqarr, Allgjatë, Arbanë, Bulticë, Damjan-Fortuzaj, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharrë
					Kashar	Fshatrat; Kashar, Yzberish, Mézez, Yrshek, Katundi i Ri, Kus, Mazrek
					Pezë	Fshatrat; Pezë e Madhe, Pezë Helmës, Pezë e Vogel, Varosh, Maknor, Dorëz, Gror, Grecë, Pajanë, Gjysyllkanë
					Ndroq	Fshatrat; Ndroq, Zbarçe, Kërçukje, Zhurje, Lage e Re, Pinet, Sauçet, Çalabërzezë, Shesh, Grebllesh, Mënik
					Zall-Herr	Fshatrat; Zall - Herr, Dritas, Çerkezë-Morinë, Qinam, Kallmet, Herraj, Pinar, Priskë e Vogel, Radhesh

Vihet re se fshati Pashkashesh bën pjesë në Njësinë Administrative Bërzhitë të Bashkisë Tiranë, Qarku Tiranë.

3. Përshkrim i projektit

Shoqëria “Kronos Konstruksion” sh.p.k është një shoqëri e krijuar me synimin për të zhvilluar aktivitetin e vet ekonomik në sferën e prodhimit të materialeve të ndërtimit, realizimit të ndërtimeve të ndryshme, etj.

Objekti i kërkuar për shfrytëzim në zonën 122/9, Pashkashesh ndodhet larg, në vijë ajrore, qendrave të banuara.

Karriera e gurit gëlqeror ka një sipërfaqe prej 0.036 km² ose 3.6 ha dhe një kapacitet prodhues 20 000 m³/vit.

Teknologjia që do të përdoret për prodhimin e gurit gëlqeror është e thjeshtë, duke instaluar makineritë e hapjes së birave, cekicët thyerës të gurit, makinat vetngarkuese dhe ato të transportit të gurit gëlqeror.

Kantieri normalisht do të punojë me një turn dhe në varësi të kërkesës për këto prodhime, karriera do të punojë me orare të zgjatura, pa e ndërprerë prodhimin deri në plotësimin e kërkesës.

4. Karakteristikat e projektit karrierë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror

5.1 Kryerja e punimeve për shfrytëzimin e karrierës

Kryerja e punimeve të shfrytëzimit në qiell të hapur favorizohet nga:

- Rënia e formacioneve, që ndërtojnë pakon produktive në drejtim horizontal deri në drejtim të kundërt me terrenin;
- Fortësia e përshtatshme e mbulesave deluvionale;
- Hidrografia e zonës e cila nuk krijon probleme për shfrytëzimin e vendburimit;
- Hidrologjia të cilat nuk janë të pranishme në zonën e shfrytëzimit;
- Koeficienti i vogël i shfrytëzimit, në sajë të të cilit nuk ka nevojë për sipërfaqe të mëdha të depozitimit të përhershëm dhe të përkohshëm të sterileve.

Për realizimin e prodhimit të parashikuar karriera do të punojë 12 muaj, 26 ditë/muaj me një ndërresë në ditë dhe me 8 orë/ditë.

5.2 Parashikimi i realizimit të prodhimit në objekt

Në këtë vendburim janë kryer punime të ndryshme rievimi si dhe janë bërë dokumentime të sistemeve të carjeve të formacioneve që ndërtojnë vendburimin si dhe janë marrë kampionet e nevojshme për kryerjen e analizave kimike e fiziko-mekanike të gëlqerorëve të vendburimit.

Shfrytëzimi i kësaj karriere do të bëhet në qiell të hapur. Infrastruktura e karrierës është pothuaj e gatshme pasi zona në studim lidhet me rrugën ekzistuese që lidh fshatin Pashkashesh me qytetin e Tiranës. Me vonë mund të lindë nevoja e hapjes së një segmenti të ri rrugor për të mbërritur në kufirin verior të zonës dhe më tej në brendësi të saj deri në nivelet e sipërme të shfrytëzimit.

Drejtimi i shfrytëzimit do të jetë nga pjesa lindore në drejtim të perëndimit.

Rezervat e objektit janë llogaritur me metodën e prerjeve horizontale duke matur sipërfaqen në prerje të pakos produktive në cdo shkallë, duke ditur që vendburimi do të shfrytëzohet me karrierë.

Volumi i gurit që do të prodhohet në një ditë, do të jetë 84 m³/ditë

Volumi vjetor do të jetë 20,000 m³/ vit

5.3 Rradha dhe drejtimi i shfrytëzimit

Rradha e shfrytëzimit: Pas kryerjes së skarifikimeve, gërmimeve dhe sistemimeve të ndryshme, parashikohet të fillojë edhe prodhimi i gurit gëlqeror në sasinë e parashikuar prej 20 000 m³/vit.

Në përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit, rradhës së shfrytëzimit dhe elementëve të tjerë, janë marrë në konsideratë:

1. Topografia e objektit në zonën e shfrytëzimit dhe për rreth saj ;
2. Sasia e rezervave të nxjerrshme në kuota të ndryshme të vendburimit. Sasia e mbulesës dhe e sterilave që duhet të zhvendosen jashtë zonës së shfrytëzimit;
3. Koeficienti mesatar i zbulimit ;
4. Mundësitë e lidhjes së vendburimit me rrugën rurale
5. Karakteristikat fiziko-mekanike dhe gjeomekanike të formacioneve që ndertojnë vendburimin;
6. Sistemi i çarjeve, orientimi i tyre dhe materiali mbushës që ndodhet në to;
7. Tregues të rendesishëm gjeomekanikë dhe gjeoteknikë si RQD dhe RMR;
8. Infrastruktura ekzistuese dhe përmirësimet e saj;
9. Eksperienca e shfrytëzimit në zonën përreth

Sikunder duket edhe nga terreni, në afërsi të objektit kalon rruga e kategorisë së katërt. Nga kjo rrugë do të devijohet në drejtim të kuotës së sipërme +690 dhe më tej me lidhjen e rrugës në shkallën e sipërme +690m në kuotën me të sipërme do të fillojë hapja e transheseve prapë në ato shkallë dhe paralelisht me shfrytëzimin në të, do të vijojë të hapet kjo transhe nga lartë-poshtë duke filluar nga niveli aktual i rrugës pastaj në kuotat respektive të shkallëve në distancë të shkurtra me radhë për shkallët e poshtme. Këto transhe do të hapen horizontale duke ndjekur izoipsin në horizontin përkatës. Gjerësia e këtyre transheve do të jetë e njëjtë me atë të transheseve kryesore (të hapjes) të brendshme. Drejtimi i hapjes së transheseve prapë do të jetë nga lindja në perëndim dhe anasjelltas në varësi të vendit të hapjes së saj nga transheja kryesore në trajtë serpentine dhe nën të do të hapen transhete prapë për formimin e shkallëve në çdo 10 m disnivel për fillimin e shfrytëzimit të objektit.

Drejtimi i shfrytëzimit: Drejtimi i shfrytëzimit të objektit do të jetë përgjithësisht nga kufiri lindor për në perëndim drejt nivelit fundor të objektit. Orientimi i përgjithshëm i shkallëve do të jetë sipas izohipseve të terrenit nga lindja për në perëndim.

Elementët gjeometrikë të karrierës në gjendje përfundimtare: duke patur parasysh pozicionin gjeografik të karrierës, relievin dhe parametrat gjeometrikë të shkallëve, karriera do të jetë në formën e stadiumit me zgjatje jug - veri me parametrat e mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------------|------|
| 1. Thellësia vertikale e karrierës | 70 m |
| 2. Numri i shkallëve | 7 |
| 3. Këndi i shuarjes të shkallëve | 63° |
| 4. Lartësia e shkallës | 10 m |

- | | |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|
| 5. kendi i pjerresise se skarpatave te shkalleve | 68-73 ⁰ |
| 6. Orientimi i transheve të hyrjeve eshte nga kryq terrenit nga lindja drejt perendimit nga qendra per ne periferi (ne varesi te mbritjes se transhese kryesore) veri-jug | |
| 7. Sipërfaqja e karrierës në plan | 0.036 km ² |

5.4 Punët me lëndët plasëse

Rrezimi i shkembinjëve gelqerore do të realizohet me një nga metodat e njohura me bira të shkurtra marteli, me puse sonde, dhe rrezimi me dhoma minash, metoda të cilat mund të aplikohet në objekt.

Kryerja e punimeve të shpim-plasjes do të kryhen nga njerëz të specializuar në këtë profesion dhe të drejtuar nga një inxhinier miniere në bazë të pasaportës të shpim-plasjes të hartuar për këtë karrierë.

Mbushja, taposja dhe ndezja e minave do të bëhet nga zjarmëtari, i cili do të jetë i pajisur me lejen e zjarmëtarit nga RISHM – Tiranë.

Kapsollat mund të jenë:

- a. Elektrike të thjeshta me numur “zero” që shperthejne ne te njejten kohe
- b. Kapsolle elektrike me numura e kohe vonese milisekondaren 25 milisekonda ose 35 milisekonda

Shpërthimi i minave do të kryhet duke marrë më parë masat e parashikuara në Rregulloren e Sigurimit Teknik për Punët Plasëse e Shpërthyesë.

5.5 Organizimi

Karriera e shfrytëzimit të gurit gëlqeror në objektin mali i Pashkasheshit do të jetë nën administrimin e shoqërisë “Kronos Konstruktion” sh.p.k.

Për realizimin e aktivitetit mineral do të jetë personeli i mëposhtëm:

- | | |
|-----------------------|---|
| 1- Drejtues teknik | 1 |
| 2- Eskavatorist | 1 |
| 3- Shofer | 2 |
| 4- Sondiste + ndihmës | 1 |
| 5- Roje objekti | 2 |

Në karrierë do të punohet me një turn dhe 26 ditë në muaj dhe proceset e punës do të jenë tërësisht të mekanizuara. Karriera është parashikuar me një prodhim vjetor prej 20 000 m³.

Punonjësit që do të punesohen do të jenë me eksperience në kryerjen e proceseve të ndryshme të karakterit mineral.

Masat për rregullimin e infrastrukturës

Në zonën e shfrytëzimit dhe afër saj nuk ka asnjë objekt industrial, social kulturor apo shtëpi banimi. Të tre krahët e kodrës janë plotësisht të mbrojtura. Kuota me e ulet është +620m ne jug, dhe me e latre +700 ne veri drejt kodrave që rrethojnë objektin ku kodra vjen e ngrihet mbi nivelin e detit. Marrja e gurit gëlqeror në formë shtrese ka mundësi që në përfundim të shfrytëzimit të krijohet mundësia e sistemimit dhe mbjelljes së drurëve dhe shkurreve karakteristike të bimësisë së zonës.

Hapja e kanaleve për drenazhim midis kollonës mbrojtëse dhe zonës së shfrytëzimit

Midis kollonës së shfrytëzimit dhe kollonës mbrojtëse të karrierës për shfrytëzim do të hapen kanale me përmasa 60 x 50 cm dhe me pjerrësi 5 % nga të dy krahët e karrierës. Me anën e këtyre kanaleve do të sigurohet kullimi i ujërave të reshjeve atmosferike, të cilat do të drenohen direkt për në përroin që kalon pranë. Me këto masa do të evitohen fenomenet e erozionit në zonën e sigurisë dhe në të gjithë karrierën.

Punimet plotësuese për mbylljen e karrierës

Krahas punimeve për shfrytëzimin e karrierës, do të kryhen edhe punime që shërbejnë për mbylljen e saj, duke realizuar synimin përfundimtar, që është rehabilitimi ambiental i zonës së shfrytëzuar. Në këtë fazë parashikohet të bëhen:

- Hapja e rrugëve lidhëse të shesheve të depozitimit të mbetjeve dhe dherave në zona që nuk do të shfrytëzohen
- Sistemimi i skarpateve për një rikthim të peisazhit në një gjendje të përafërt me atë të para shfrytëzimit
- Mbjellja e fidanëve në zonën e kollonës mbrojtëse dhe në zonën që do të shfrytëzohet
- Sistemimi dhe punime sigurimi për depozitimin e mbetjeve
- Shmangia e gropave apo thellimeve në zonën e shfrytëzuar dhe brigjeve
- Risjellja e shpateve dhe brigjeve në të njëjtat kushte si para shfrytëzimit
- Parashikimi dhe realizimi i masave të ndryshme restauruese për një regjim normal të rrjedhjes

5. Informacion mbi përzgjedhjen e vendndodhjes së projektit

Theksojmë se jemi në një zonë plotësisht të destinuar për aktivitete të prodhimit të materialeve inerte, dhe nuk ka asnjë banesë pranë këtij objekti. Po ashtu sipërfaqet e lira rrethuese të objektit do të mbillen me pemë dekorative, në bazë të planit të rehabilitimit të karrierës së gurit gëlqeror të shoqërisë.

Në mënyrë të përmbledhur, aspektet positive të përzgjedhjes së vendndodhjes ku do të zhvillohet ky aktivitet paraqiten si më poshtë:

- ❖ Nga vlerësimi i zonës rezulton se në këtë zonë nuk ka
 - Pasuri natyrore tokë bujqësore, pyje, kullota;
 - Vepra të infrastrukturës si rrugë automobilistike;
 - Linja tensioni të lartë;
 - Burime uji;

- Vendbanime apo objekte social-kulturore;
- Vepra arti apo vepra të tjera të mbrojtura me ligj;
- Monumente të karakterit historic, të trashëgimisë kulturore, gjeomonumnte të arkeologjisë apo të tjera që mund të dëmtohen nga zhvillimi i aktivitetit;
- ❖ Vendi i karrierës ndodhet relativisht larg nga zonat e banuara, në një distancë rreth 600 m nga zona më e afërt;
- ❖ Zona përreth siguron cilësi të gëlqerorit;
- ❖ Ka infrastrukturë pothuaj të gatshme;
- ❖ Vendi nuk ka problem hidrogjeologjike, pasi ka rezultuar se nuk ka urime ujore nëntokësore që mund të dëmtohen. Gjithashtu pranë tij nuk ka burime të ujit të pijshëm;
- ❖ Mbetjet teknologjike të dala nga shfrytëzimi i karrierës do të ripërdoren për qëllime rehabilitimi, ose qëllime të vet subjektit;
- ❖ Toka është e lirë nga sipërfaqe bujqësore apo pyjore;
- ❖ Kryerja e aktivitetit në përgjithësi nuk krijon ndotje të ujit, ajrit dhe tokës.

6. Identifikimi i ndikimeve

1. Ndikimet në tokë

Nga zbatimi i këtij projekti ndikimet në tokë do të jenë të konsiderueshme, duke menduar edhe shtrirjen e tij në një sipërfaqe prej 3.6 ha. Kuptohet që nuk do të shfrytëzohet e gjitha menjëherë por gradualisht. Kjo jep mundësinë e rehabilitimit të pjesshëm të zonës. Për të kryer një rehabilitim të plotë dhe afatgjatë, duhet që shfrytëzimi të jetë me shkallë të rregullta dhe të jetë ruajtur shtresa e dheut në sipërfaqen e gërmuar. Përdorimi i tokës konsiston në shfrytëzimin afatgjatë të saj si shesh i punimeve të karrierës, por edhe në zënien e saj për depozitimin e përkohshëm të sterileve, parkimi, etj.

Në lidhje me efektin e erozionit projekti nuk do të ndikojë në këtë fenomen. Zona, ku do të kryhet shfrytëzimi, nuk do të ndryshojë pjerresinë në thellësi të shfrytëzimit. Germimi është parashikuar të bëhet në një thellësi të vogël dhe me një kënd shuarje të karrierës gati të barabartë me atë të terrenit. Mbushja vit pas viti e sipërfaqes së shfrytëzuar dhe sistemimi do të krijojë mundësinë e mbjelljes së druveve pyjore dhe ndryshimin e përmirësimit të peisazhit të prishur.

Shfrytëzimi nuk do të shkaktojë humbje të pjerresisë së tokës dhe nuk do të favorizojë erozionin e saj.

Në projektin e shfrytëzimit të objektit duke qenë se është vende vende i mbuluar nga një shtresë e hollë 10 cm mbulesë është parashikuar që materiali që do të dalë nga zbulimi, sterilet, do të depozitohet në pjesët anësore të shkallëve brenda kufijve të karrierës. Ky material, duke u përzier me atë të prodhuar në karrierë, do të përdoret pjesërisht për stabilizant për shtrimin e rrugëve dhe në se do të ketë kërkesa do të shitet të tretëve. Pjesa që do të mbetet do të përdoret për rigjenerimin e zonës së shfrytëzuar. Pra nga zbulimi dhe aktiviteti i shfrytëzimit të këtij objekti nuk do të krijohet ndotje të tokës nga mbetjet e ngurta.

Gjatë procesit të shfrytëzimit të gurit gëlqeror në karrierë nuk do të krijohen llumra, pasi ujërat që vijnë nga shpati dhe ujërat e shiut do të drejtohen nëpërmjet kanalit të ndërtuar më

parë dhe nuk do të futen në karrierë. Uji që do të përdoret për spërkatje do të jetë në sasira të vogla.

2. Ndikime në topografinë lokale, erozionin e tokës

Gjatë dhe pas shfrytëzimit nuk do të ketë ndryshime në topografinë lokale. Projekti mbi të gjitha ndikon në shkëmb dhe tokë. Është një sasi e konsiderueshme e materialit inert që do të merret nga territori që trajtojmë. Në këtë sasi materiali përfshihet edhe shtresa e hollë e dheut (aty ku ekziston), materiali i shkrifët nga zgavrat nëntokësore të gëlqerorit edhe vetë guri gëlqeror.

Nga kryerja e aktivitetit minerar nuk shkaktohet erozion mbasi kushtet e terrenit janë të tilla që e përjashtojnë një gjë të tillë. Kendi i shuarjes së shkalleve në projekt është pranuar 63° - 68° . Ky kënd është më i vogël se këndi i ferkimit të brendshëm të këtyre formacioneve dhe gati i barabartë me atë të terrenit. Kështu që jo vetëm në fund të shfrytëzimit, por edhe gjatë procesit të tij nuk do të ketë erozion.

Në projekt është parashikuar një rrathë dhe drejtim i tillë i shfrytëzimit, që në kombinim me masat e tjera suplementare të mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin, shembjen dhe vithisjen e shpateve të karrierës dhe sipërfaqes së tokës rreth saj.

3. Ndikimet në ujë

Zona ka rezerva të pakta ujore. Përhapja e gjerë e depozitimeve terrigjene krijon kushte të papërshtatshme për grumbullimin e ujërave nëntokësore, që pasqyrohet nga burimet e pakta dhe sasia e tyre në gjithë zonën. Strukturat sipërfaqësore, nga ana tjetër, favorizojnë kryesisht vetëm rrjedhjet e përkohshme me karakter vërshimi nga reshjet e rrëmbyera. Konfigurimi i kodrës dhe këndi i pjerrësisë së shpateve ka bërë që rrjedhjet sipërfaqësore në shpate të grumbullohen gjatë gjithë pjesës së poshtme të kodrës, përfshi edhe zonën poshtë territorit që do të përdoret si gurore.

Ekzistenca e shkëmbinjve gëlqeror ka kushtëzuar shtresa ujëpërcuese të cilat si nga strukturat vertikale edhe nga pozicioni vertikal nuk lejojnë grumbullimin e ujërave nëntokësorë, por nuk duhet harruar se mund të ketë forma të karstit të zhvilluara në thellësi të tokës dhe brendësi të shkëmbit. Pra, zbatimi mund të efektojë disi në zgavrimin e mëtejshëm të të carave të gëlqerorit nga rritja e sasisë dhe intensitetit të përshkimit të shkëmbit nga ujërat sipërfaqësore të reshjeve, për shkak të reduktimit të materialit të gjelbër që mbulon vende – vende territorin, duke rritur kështu kapacitetin e infiltrimit. Rritja e masës së ujit në ujëmbajtësit karstikë, deri në nivelet e mbingopjes do të intensifikonte shkrirjen e gëlqerorit dhe rritjen e aktivitetit të karstit.

Ujërat e reshjeve dhe ujërat që do të vijnë nga shpati i kodrës do të grumbullohen dhe do të drejtohen në kanalën që do të hapet në pjesën e sipërme të karrierës.

4. Ndikimet në ajër

Përsa i përket shkarkimeve në ajër nga zhvillimi i aktivitetit nuk do të emetohen gaze të dëmshëm në atmosferë për mjedisin apo banorët e zonës përreth. Referuar natyrës së procesit

nuk kemi sasi gazesh të shkarkuar në atmosferë, por vetëm grimca pluhuri. Për të minimizuar këtë ndikim, në kohë të thatë do të bëhet spërkatja e rrugëve me ujë gjatë transportit të mineralit si dhe gjatë transportit të sterilit për në sheshin e sterilit në afërsi të karrierës, në mënyrë që pluhurat të mos përhapen në mënyrë kaotike, sidomos në kohë të thatë dhe me erë.

Gjithashtu do të ketë emetim gazesh nga automjetet që do të kryejnë transportin. Sasia e tyre do të jetë minimale pasi do të punohet me eficiencë dhe koha e mbajtjes ndezur të motorrëve të mjeteve do të jetë e ulët.

Duke marrë parasysh që qëndrat e banuara janë në një distancë relativisht të largët nga zona e shfrytëzimit këto emetime janë mospërfillëse.

5. Ndikime në zhurma dhe vibrime

Ndikimet nga zhurmat do të jenë tepër të përkohshme. Aktiviteti nuk parashikon të gjenerojë zhurma jashtë normave të lejuara. Janë parashikuar plasje të mirëplanifikuara dhe të kontrolluara, bazuar në rregulloren e sigurisë të cilat janë me kohëzgjatje të ulët dhe me impakt të vogël. Karriera ndodhet larg qendrave të banuara dhe ata që janë më të prekur nga ky ndikim, punonjësit, janë të pajisur me mjete mbrojtëse nga zhurmat si kufje, tapa etj. Për sa i përket zhurmave që gjenerohen gjatë gërmimit dhe transportimit janë brenda normave të lejuara për mjedisë pune 8 orë.

Vibrimet do të shkaktohen kryesisht si pasojë e shpërthimeve nga lëndët plasëse, nga gërmimet e dheut si dhe nga makineritë e transportit. Nivelet e tyre do të jenë brenda normave dhe për një kohëzgjatje të shkurtër.

6. Ndikimet në biodiversitet

Ndikimi kryesor dhe më i rëndësishëm në mjedisin biologjik do të jetë gjatë fazes së punimeve për hapjen dhe shfrytëzimin e karrierës. Vetë natyra e projektit bën që të ketë ndikim në florën dhe faunën e zonës, edhe pse këto janë të paktë në zonë, por ky ndikim do të jetë i vogël. Sidoqoftë, masat mjedisore gjatë shfrytëzimit, do të evitojnë ndikimet në mjediset përreth, duke influencuar në reduktimin e ndikimeve hapësinore në florën ekzistuese në shpatet përreth karrierës. Barërat dhe shkurret do të jenë ato elementë që do të preken nga zhvillimi i projektit.

Ndikimi real do të bjerë mbi dheun dhe shkëmbin sipërfaqësor, dmth dëmtim radikal i habitatit të florës dhe direkt mbi vegjetacionin duke e larguar plotësisht atë nga territori që do të shfrytëzohet.

Ndikimet mbi faunë do të jenë të ndryshme, mbi klasa të ndryshme të saj. Po ti referohemi pasurisë së zonës në faunë, del se klasa që ka ndikime të rëndësishme është ajo e zvarranikëve. Por speciet që do të preken janë të parëndësishme dhe nuk figurojnë ndër ato të rrezikuara, mbrojtura, endemike apo kërcënuara. Një ndikim të parëndësishëm do të ketë gjithashtu gjatë shfrytëzimit të zonës, në shpendët që pushojnë apo gjuajnë në territor.

7. Ndikime në infrastrukturën e zonës

Në këtë zonë që do të shfrytëzohet infrastruktura është pothuaj e gatshme. Objekti ndodhet në afërsi të rrugës që lidh fshatin Pashkashesh me fshatrat përreth dhe me Tiranën. Mjetet e transportit të materialeve inerte do të kalojnë nga kjo rrugë automobilistike, të cilën shoqëria do ta mirëmbajë vazhdimisht.

8. Ndikime në trashëgiminë kulturore

Si rezultat i zbatimit të projektit në këtë zonë nuk do të ketë ndikim negativ mbi ndërtimet, trashëgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, pasi në këtë zonë nuk ka të tilla. Gjithashtu nuk ka ndikim mbi veprat e tjera njerëzore, sepse në këtë zonë dhe përreth saj nuk ka asnjë objekt të një rëndësie të vecantë të karaktereve të lartpërmendura.

9. Ndikime të tjera

Investimet që do të kryhen për vënien në punë të gurores do të ndikojnë edhe në drejtim të mjedisit human. Ky ndikim është shumëpalësh. Ai mund të jetë i drejtpërdrejtë ose indirekt, sikurse mund të jetë si negative ashtu edhe pozitiv.

Ndikimi i drejtpërdrejtë përfshin hapjen, shfrytëzimin dhe më pas rehabilitimin e karrierës dhe rrethinave të saj si: vendburim i lëndës së parë, si dhe rrugën që lidh sheshin e gurores me rrugën nacionale që të con në Tiranë.

Ndikimi indirekt përfshin disa aspekte të aktivitetit ekonomik ku përdoren gjerësisht materialet e prodhuara nga kjo gurore.

Ndikimet positive të këtij projekti konsistojnë edhe në aspektin social-ekonomik. Kështu, ky projekt do të ndikojë në rritjen e punësimit, rritjen e të adhurave të njësisë së qeverisjes vendore nëpërmjet taksave dhe rentës minerare. Ndikim tjetër në aspektin social do të jetë zbutja e efekteve të emigracionit dhe e konflikteve sociale të shkaktuara nga gjendja e dobët ekonomike. Këto ndikime do të shtrihen në kohë për aq kohë sa do të funksionojë karriera.

7. Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit ndërkufitar. Projekti nuk ndikon në çënimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinjë, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore ndërkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin ndërkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendndodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinjë.